

GJYKATA EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Deklaratë për shtyp lëshuar nga Regjistruesi i Gjykatës

GJYKIM I DHOMËS

GLOR v. ZVICRËS

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka njoftuar sot me shkrim në vendimin e saj të Dhomës¹ në rastin *Glor kundër Zvicrës* (ankimi nr. 13444/04). Gjykata vendosi unanimisht se ka pasur **një shkelje të Nenit 14** (ndalimi i diskriminimit), **marrë në lidhje me Nenin 8** (e drejta për të respektuar jetën private dhe familjare), të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me detyrimin e ankuesit për të paguar një taksë për t'u përjashtuar nga shërbimi ushtarak për arsye mjekësore, pavarësisht faktit se ai ka qenë i gatshëm për të kryer shërbimin e tij.

Sipas Nenit 41 (thjesht përmbushje e detyrimit) të Konventës, Gjykata i akordoi ankuesit 3,650 euro (EURO) për kostot dhe shpenzimet. (Aktgjykimi është i disponueshëm vetëm në gjuhën frënge.)

1. Faktet Kryesore

Ankuesi, Sven Glor, është një shtetas i Konfederatës Zvicerane, lindur në vitin 1978, me banim në Dällikon (kanton i Zyrihut). Ai është një shofer kamioni.

Më 14 mars 1997 ai u shpall i papranueshëm për shërbimin ushtarak duke qenë se ai vuante nga diabeti (diabet mellitus të tipit 1). Ai u lirua më pas nga Shërbimi i Mbrojtjes Civile në vitin 1999.

Më 9 gusht 2001 ankuesi mori urdhër të paguante tatimin e përjashtimit nga shërbimi ushtarak (477 euro), të cilën ai e refuzoi.

Më 20 shtator 2001 Administrata Tatimore Federale rekomandoi kryerjen e ekzaminimve shtesë për të verifikuar nëse ankuesi ishte ose jo të paktën 40% me aftësi të kufizuara, pragu për një "aftësi të kufizuar madhore" sic përcaktohet në të drejtën sipas praktikës së mëparshme të Gjykatës Federale dhe për mos-detyrim të tatimit të përjashtimit.

¹ Sipas Nenit 43 të Konventës, brenda tre muajve nga data e Gjykimit të Dhomës cdo pale mund, në raste të jashtëzakonshme, të kërkojë që çështja ti referohet Dhomës së Madhe të përbërë nga 17 anëtarë të Gjykatës. Në këtë rast një panel prej pesë gjyqtarësh do të konsiderojë nëse çështja ngre një problem serioz I cili ndikon në interpretimin ose zbatimin e Konventës ose protokolleve të saj, ose një çështje serioze me rëndësi të përgjithshme, rast në të cilin, Dhoma e Madhe do të japë një gjykim përfundimtar. Nëse kërkesa për referim refuzohet, gjykimi i Dhomës do të jepet në formë të prerë pas skadimit të një afati tre-mujor ose më parë nëse palët deklarojnë se nuk synojnë të bejnë kërkesë për referim.

Më 15 korrik 2003 autoritetet përgjegjëse të taksës së përjashtimit gjetën në bazë të dy raporteve të ekspertëve - nga një spital universitar dhe një mjek i ushtrisë - që ankuesi nuk mund të përjashtohet nga taksa duke qenë se shkalla e tij e paaftësisë ishte më e ulët se 40%.

Më 9 mars 2004, Gjykata Federale hodhi poshtë një apel nga ankuesi, i cili përsëri dyshonte të kishte qenë objekt trajtimi diskriminues duke u detyruar të paguante taksën e përjashtimit, dhe se ai ishte penguar të kryente shërbimin ushtarak edhe pse kishte deklaruar gjithnjë gatishmërinë e tij për tabërë këtë.

Gjykata Federale vuri në dukje se, edhe pse lloji i diabetit të ankuesit nuk mund ta pengonte atë të kryente një një aktivitet normal profesional, kërkesat e veçanta të shërbimit ushtarak nënkuptonin që ai duhej të deklarohet i papranueshëm për atë qëllim. Ajo u shpreh se autoritetet thjesht kishin zbatuar dispozitat në fuqi sipas rastit, me qëllim sigurimin e barazisë mes atyre që kryenin shërbimin ushtarak dhe atyre që ishin përjashtuar nga e drejta për ata kryer atë.

2. Procedura dhe përbërja e Gjykatës

Kërkesa u dorëzua në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut më 22 mars 2004.

Gjykimi u dha nga një Trup prej shtatë gjyqtarësh, i përbërë si vijon:

Nina **Vaji** (Kroaci), *Kryetar*,
Anatoly **Kovler** (Rusi),
Elisabeth **Steiner** (Austri),
Khanlar **Hajiyev** (Azerbajxhan),
Sverre Erik **Jebens** (Norvegji),
Giorgio **Malinverni** (Zvicër),
George **Nicolaou** (Qipro), *gjyqtarë*,

dhe gjithashtu André **Ēampach**, *Zv. Regjistruer i Seksionit*.

3. Përmbledhje e Gjykimit²

Ankesa

Bazuar në Nenin 14 marrë në lidhje me Nenin 8, ankuesi u ankua se ai ishte diskriminuar për faktin se ai ishte penguar kundër vullnetit të tij nga kryerja e shërbimit ushtarak, duke qenë i detyruar të paguante taksën e përjashtimit, duke qenë se aftësia e kufizuar e tij nuk ishte konsideruar si madhore nga autoritetet.

Vendim i Gjykatës

Neni 14 marrë në lidhje me Nenin 8

Gjykata vuri re se nocioni i jetës private sipas Nenit 8 përfshinte integritetin fizik të një personi dhe se një taksë e shtetit bazuar mbi paaftësinë për të shërbyer në forcat e armatosura për arsye mjekësore në mënyrë të padiskutueshme binte në kuadër të atij neni

² Kjo përmbledhje nga Regjistri nuk është detyruese për Gjykatën.

Gjykata vlerësoi se autoritetet zvicerane i kishin trajtuar personat në situata të ngjashme në mënyra të ndryshme në dy aspekte: së pari, ankuesi ishte i detyruar të paguante taksën e përjashtimit, ndryshe nga personat me aftësi të kufizuara më të rënda, dhe së dyti, ai nuk ishte në gjendje të kryente shërbim alternativ civil, i cili sipas legjislacionit zviceran rezervohej për kundërshtuesit e ndërgjegjshëm.

Dallimi i parë në trajtim, sipas Qeverisë së Zvicrës, ishte projektuar për të rivendosur barazinë midis atyre që kryenin shërbimin ushtarak dhe atyre që ishin përjashtuar nga kryerja e një shërbimi të tillë, duke qenë se një taksë e tillë ishte zëvendësuese për përpjekjet e atyre që kryenin shërbimin e tyre.

Gjykata nuk ishte e kënaqur që duhej në interes të komunitetit ti kërkontë ankuesit të paguante një taksë përjashtimi për zëvendësim të përpjekjeve të shërbimit ushtarak, i cili ishte penguar ta kryente për arsye mjekësore, një situatë faktike jashtë kontrollit të tij. Gjykata gjithashtu theksoi se roli parandalues i taksës ishte i lehtë, duke konsideruar se forcat e armatosura zvicerane kishin një numër të mjaftueshëm njerëzish në dispozicion të cilët ishin të gatshëm për shërbim ushtarak, dhe vuri në dukje se të hyrat financiare nga ai ndoshta nuk ishin të parëndësishme. Ajo më tej vuri re se një taksë e këtillë nuk ekzistonte në shumicën e vendeve të tjera.

Sipas mendimit të ankuesit, shuma prej 477 EUR që ai duhet të paguante në lidhje me taksën në fjalë nuk mund të përshkruhej si e parëndësishme, veçanërisht pasi të ardhurat e tij ishin modeste dhe tatimi mbahej në vit gjatë periudhës së shërbimit të detyrueshëm, që arrinte në të paktën tetë vjet.

Lidhur me vlerësimin e shkallës së aftësisë së kufizuar të ankuesit, Gjykata vlerësoi se autoritetet zvicerane nuk kishin marrë parasysh mjaftueshëm rrethanat e tij personale. Ata ishin mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Federale dhe në një precedent që zori se mund të krahasohej - rasti i një invalidi - në gjetjen se shkalla e aftësisë së kufizuara të ankuesit ishte më pak se 40%. Gjykata më tej vuri në dukje se legjislacioni nuk parashikonte ndonjë përjashtim nga taksa në fjalë për ata që ishin nën pragun e 40% të aftësisë së kufizuar dhe të cilët kishin vetëm të ardhura modeste.

Gjykata sugjeroi se njerëzve në rastin e ankuesit mund t'iu ofrohej mundësia e formave alternative të shërbimit në forcat e armatosura që kërkonte përpjekje më pak fizike dhe ishin në përputhje me kufizimet e paaftësisë së pjesshme - në rastin e tij, injeksione insuline katër herë në ditë - ose të shërbimit civil, pa këtë opsion i cili rezervohej vetëm për kundërshtuesit e ndërgjegjshëm.

Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të Nenit 14 marrë së bashku me Nenin 8, në gjetjen se ankuesi kishte qenë viktimë e trajtimit diskriminues duke qenë se nuk ka pasur arsye të bazuar për dallimin e bërë nga autoritetet zvicerane ndërmjet, në veçanti, personave të paaftë për shërbim dhe të cilët nuk i nënshtrohen tatimit në fjalë dhe atyre që ishin të paaftë për shërbim, por megjithatë ishin të detyruar të paguanin tatimin.